# VENDIM
## Nr. 498, datë 13.9.2017

## PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT (AKKSHI), TE DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERITARE, TË PRONËS SË PALUAJTSHME SHTETËRORE, APARTAMENTET NR. 15, NR. 16, NR. 17, NR. 18, TË NDODHURA NË GODINËN NR. 57, NË BULEVARDIN "ZOGU I", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 901 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), te Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, të pronës së paluajtshme shtetërore, apartamentet nr. 15, nr. 16, nr. 17, nr. 18, të ndodhura në godinën nr. 57, në bulevardin "Zogu I", Tiranë, sipas planimetrive bashkëlidhur këtij vendimi, për t'ua dhënë në përdorim dhe pa shpërblim, si mjedise pune, ish-presidentëve të Republikës së Shqipërisë.

2. Pronat e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme të DSHQ-së, miratuar me vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**


PLANIMETRIA E KATIT TE KATERT
Shkalla 1 : 100
Ap. 1 + 1
15
16
SHKALLA II
Ap. 3 + 1
SHKALLA I
Shkalla I
Sip. Ap. 3, 2 + 1 = 77.8 m 2
Sip. Ap. 4, 1 + 1 = 59.6 m 2
Sip. Kafaz Shkalle = 28.2 m 2
Sip. Totale = 165.6 m 2
Shkalla II
Sip. Ap. 15, 3 + 1 = 99.8 m 2
Sip. Ap. 16, 1 + 1 = 59.6 m 2
Sip. Kafaz Shkalle = 28.2 m 2
Sip. Totale = 187.6 m 2
PALLATI 37/1,2
PPLANIMETRIA E KATIT TE KATERT
DREJTORIA E SHERBIMIT DIPLOMATIK
Nr. LICENSES
FIRMA
SH.P.K. " GJEOFOTO "



PLANIMETRIA E KATIT TE PESTE
Shkalla 1 : 100
Ap. 1+1
17
18
SHKALLA II
Ap. 3+1
SHKALLA I
Shkalla I
Sip. Ap. 5, 2 + 1 = 77.8 m 2
Sip. Ap. 6, 1 + 1 = 59.6 m 2
Sip. Kafaz Shkalle = 28.2 m 2
Sip. Totale = 165.6 m 2
Shkalla II
Sip. Ap. 17, 3 + 1 = 99.8 m 2
Sip. Ap. 18, 1 + 1 = 59.6 m 2
Sip. Kafaz Shkalle = 28.2 m 2
Sip. Totale = 187.6 m 2
OBJEKTI
PALLATI 57/1,2
TITULLI I FLETES
PLANIMETRIA E KATIT TE PESTE
POROSITES
DREJTORIA E SHERBIMIT DIPLOMATIK
GRUPI I PUNES
Nr. LIÇENSES
FIRMA
SH.P.K. " GJEOFOTO "
Top. Osman TOMJA
TZ - 0383
Ing. Pellumb AHMETAJ
K - 0018/1